# Kontrata për mësimin e profesionit



Keni pasur sukses – ndërmarrja ju ka premtuar gojarisht vendin për mësimin e profesionit. Në një hap të ardhshëm, përgjegjësit në ndërmarrjen ku do të mësoni profesionin, e plotësojnë kontratën për mësimin e profesionit dhe ua dërgojnë juve. Kontratën tashmë të nënshkruar nga ndërmarrja duhet ta nënshkruani edhe ju. Atëherë kontrata është e vlefshme.

Në kontratë janë të shënuara shumë të dhëna të përgjithshme si: adresa e ndërmarrjes ku do të mësoni profesionin, të dhënat tuaja personale, emërtimin e profesionit, kohëzgjatjen e mësimit të profesionit, kohëzgjatjen e kohës provuese ose të shkollës profesionale, të cilën do ta vijoni.

Por ka edhe detaje të cilat duhet t'i shikoni pak më me vëmendje:

## Leja e punës

Për disa leje të caktuara të qëndrimit (p.sh. F, L, N) për mësimin e profesionit kërkohet edhe leja e punës. Kjo leje e punës duhet të rregullohet para fillimit të arsimimit bazë profesional.

## Përfaqësimi ligjor

Nëse keni mbushur 18 vjet dhe keni hyrë në moshë të rritur, atëherë nuk keni nevojë për përfaqësues ligjor. Si njeri i rritur e nënshkruani kontratën për mësim të profesionit dhe me këtë edhe merrni përgjegjësinë.



3. Gesetzliche Vertretung (Vater und/oder Mutter oder Vormundschafts-behörde)

| | | | |
|---|---|---|---|
| Name | | Vorname | |
| Strasse | | Geschlecht: m f | |
| PLZ/Ort | | Tel.-Nr. | |
| Name | | Vorname | |
| Strasse | | Geschlecht: m f | |
| PLZ/Ort | | Tel.-Nr. | |

## Kompensimi

Këtu është e shënuar sa është paga mujore në vitet e ndryshme të mësimit të profesionit, se a do të merrni shtesa nëse në ndërmarrje ose në shkollën profesionale jepni kontribut të jashtëzakonshëm ose nëse ndërmarrja ku mësoni profesionin parasheh pagesën e një rroge të 13-të.



7. Entschädigung

Bruttolohn

1. Bildungsjahr Fr. pro Monat Woche Stunde
2. Bildungsjahr Fr. pro Monat Woche Stunde
3. Bildungsjahr Fr. pro Monat Woche Stunde
4. Bildungsjahr Fr. pro Monat Woche Stunde

Zulagen

13. Monatslohn: ja nein

(Abzüge vom Bruttolohn ausser den gesetzlichen Sozialabzügen siehe Ziffern 11 und 12)

Nëse jeni më të vjetër se 18 vjet, atëherë prej rrogës së shënuar në kontratë zbriten kontributet gjegjëse për AHV/AVS (Sigurimi i pleqërisë, pasardhësve dhe trashëgimtarëve), IV/AI (Sigurimi për rast invaliditeti) dhe ALV/AC/AD (Sigurimi në rast të papunësisë).

## Orari i punës

Orari maksimal i punës në Zvicër është mesatarisht 42 deri 45 orë në javë. Në disa degë mund të devijohet prej këtij orari. Bisedoni me përgjegjësit në ndërmarrjen tuaj të ardhshme ku mësoni profesionin, cili është orari i punës në profesionin tuaj.

**8. Arbeitszeit**

Einschliesslich der schulischen Bildung beträgt die Arbeitszeit

Stunden pro Woche: ____ Arbeitstage pro Woche: ____

Ein Schultag bzw. -halbtag ist einem Arbeitstag bzw. -halbtag gleichzusetzen.

Bezüglich Tages-Höchstarbeitszeit, Nacht- und Sonntagsarbeit sowie allfälliger Überzeit sind die gesetzlichen Vorschriften zu beachten, insbesondere das Arbeitsgesetz mit den dazugehörenden Verordnungen.

Besondere Regelung ____

## Pajisjet e nevojshme për profesion

Për shumë profesione duhen veshmbathje të veçanta për punë dhe për vegla personale të punës. Në kontratën për mësimin e profesionit është e rregulluar nëse ndërmarrja merr përsipër furnizimin me to dhe mirëmbajtjen e tyre.

**10. Berufsnotwendige Beschaffungen**

Die lernende Person benötigt die folgenden persönlichen Werkzeuge, Berufskleider usw.

____

Die Beschaffungskosten übernimmt ☐ Lehrbetrieb ☐ Lernende Person/gesetzliche Vertretung

Die Reinigung der Berufskleider übernimmt ☐ Lehrbetrieb ☐ Lernende Person/gesetzliche Vertretung

## Sigurimet

Të rinjtë zakonisht janë të siguruar nga prindërit e tyre vetëm kundër fatkeqësive, shpesh si pjesë përbërëse e sigurimit shëndetësor. Gjatë mësimit të profesionit në ndërmarrje tani jeni të siguruar nga ndërmarrja kundër fatkeqësive gjatë punës. Ndërmarrje ku mësoni profesionin gjithashtu ju siguron edhe kundër fatkeqësive edhe nëkohën tuaj të lirë. Ky sigurim është i detyrueshëm dhe në shumicën dërmuese të rasteve zbritet nga paga e shegërtit. Informoni arkën tuaj të sigurimit shëndetësor se tashmë jeni të siguruar nga ndërmarrja për raste të fatkeqësisë.

**11. Versicherungen**

**Unfallversicherung**
Die lernende Person ist gemäss Unfallversicherung (UVG) obligatorisch versichert.
Die Prämien für die **Berufsunfallversicherung** übernimmt der Lehrbetrieb.

Die Prämien für die **Nichtberufsunfallversicherung** übernimmt ____ % Lehrbetrieb ____ % Lernende Person/gesetzliche Vertretung

**Krankentaggeldversicherung** vereinbart ☐ ja ☐ nein
Wenn ja: Die Prämien übernimmt ____ % Lehrbetrieb ____ % Lernende Person/gesetzliche Vertretung
(Der Betrieb muss mindestens 50% der Prämien übernehmen.)

## Miratimi

Kontrata për mësimin e profesionit miratohet nga Enti për Arsimimin Profesional i kantonit tuaj. Personi i cili nënshkruan është përgjegjës për profesionin tuaj, gjegjësisht për vendin tuaj të mësimit të profesionit. Në rast se keni probleme gjatë arsimimit bazë profesional, të cilat nuk mund t'i zgjidhni në bashkëpunim me ndërmarrjen tuaj ku mësoni profesionin ose me shkollën profesionale, atëherë e kontaktoni këtë person.

**15. Genehmigung**

Die kantonale Behörde genehmigt diesen Lehrvertrag.

Ort, Datum, Stempel